



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.02/2017
Prishtinë, më 17.10.2017, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha – Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetarë i parë, Dardan Molliqaj, Hykmete Bajrami, Memli Krasniqi, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Qëndron Kastrati, Mimoza Kusari – Lila dhe Gani Dreshaj, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Sylejman Blaku – Kosova Sot, Albulena Baftiu – RTK, Etleva Malushaj – LVV, Albert Krasniqi – KDI dhe Vlmir Ismaili – D+.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha - Shala, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 10.10.2017;
3. Shqyrtimi i projektplanit të punës së komisionit;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 10.10.2017

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 10.10.2017, u miratua pa vërejtje.

3.Shqyrtimi i projektplanit të punës së komisionit

Kryetarja, theksoi se projektplan i punës së komisionit, është përgatitur nga stafi i komisionit, duke përfshirë edhe Programin legjislativ për vitin 2017, i sjellë nga Qeveria. Ajo potencoi se në planin e punës së komisionit është paraparë nisma legjislative nga komisioni për hartimin e Projektligjit për miniera dhe minerale. Ajo i njoftoi anëtarët e komisionit se kjo nismë ka qenë nga legjislatura e kaluar ku projektligji është i hartuar, i ishte dërguar Qeverisë, por që ka mbetur pa u proceduar, për shkak të shpërbërjes së Kuvendit. Pra, është i gatshëm të përfshihet në plan të punës, si dhe të fillohet me proceduarat e parapara të Rregullores së Punës së Kuvendit. Kryetarja më tutje potencoi se në kuadër të kompetencave të komisionit është edhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve dhe në plan janë paraqitur disa ligje, si orientim që të zgjedhim zbatimin e një ligji, natyrisht mund të propozojmë edhe ligje tjera për mbikëqyrje të zbatimit.

Dardan Sejdiu, tha se pajtohem që të vazhdohet me nismat e mira legjislative, ndërsa lidhur me përcaktimin për mbikëqyrjen e zbatimit të një ligji, theksoi se ne duhet të dakordohemi se cili ligj do të ishte me prioritet dhe propozoi të monitorohet Ligji për Trepçën dhe Ligji për ndërmarrjet publike, pasi që kanë një rëndësi të madhe në zhvillimin ekonomik. Po ashtu, propozoi që në planin e punës së komisionit të futet edhe vizita e komisionit në Shqipëri, te komisioni homolog. Ai propozoi që të kërkohej një informatë nga Ministra e Zhvillimit Ekonomik, lidhur me kontratën me kompaninë “Contour Global”, në mënyrë që ta kemi një njoftim se çka po ndodh me këtë kontratë, si dhe informimi lidhur me linjën e interkoneksionit energjetik Kosovë – Shqipëri, se ku ka arritur dhe çka po ndodh me këtë çështje, që është në proces.

Memli Krasniqi, tha se kanë mbetur 2 muaj punë, prandaj duhet të fokusohemi më shumë në një fushëveprim të komisionit, në aspektin ligjvënës, pasi që komisioni ka një gamë të gjerë të fushëveprimet, dhe në bazë të projekt-programit legjislativ për vitin 2017, ne duhet ta konkretizojmë punën për këtë kohë që ka mbetur në këtë vit. Pastaj, për vitin 2018, kemi kohë më shumë për të zgjeruar aktivitetin e komisionit dhe theksoi se do të ishte mirë që në vitin 2018, të marrim nismë për hartimin e ligjit për tregtinë e brendshme dhe të shohim mundësitë për mbështetjen e prodhuesve vendorë. Sa i përket monitorimit të ligjeve, theksoi se ligjet e MZHE-së janë të një rëndësie të veçantë dhe propozoi të mbikëqyret zbatimin e një ligji nga MZHE-ja.

Bilall Sherifi, propozoi që të mbikëqyret Ligji për patentë shofer, pasi që në këtë vit ka pasur shumë aksidente rrugore dhe me humbje të njerëzve. Kjo do të ishte në funksion dhe të fushatave

sensibilizuese në parandalimin e aksidenteve rrugore në trafik, në mënyrë që të rritet kujdesi, sidomos te vozitësit e fillestarë.

Hykmete Bajrami, theksoi se plani i punës së komisionit për vitin 2017, sa i përket ligjeve, varet prej asaj se cilat projektligje i sjellë Qeveria, prej Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, siç shihet ka shume projektligje. Ajo propozoi që të kërkohet nga Qeveria që Projektligjet për masat mbrojtëse në importe, masat antidamping dhe tregti të brendshme, t'i sjellin në pako, pasi që janë të ndërlidhura në mes veti dhe ne si komision duhet t'i shqyrtojmë në pako. Te mbikëqyrja e ligjeve, ne duhet t'i vizitojmë edhe palët e interesit, për të marrë opinionin e tyre se cilat janë pengesat që kanë dhe sa po zbatohen ligjet. Lidhur me raportet e agjencive të pavarura dhe ndërmarrjeve publike, duhet të ndërmerret diçka, pra të bëhet plotësim-ndryshimi i Rregullores së Punës së Kuvendit, nëse nuk iu miratohet raporti vjetor i punës së tyre, atëherë duhet të shkarkohen bordet e këtyre agjencive dhe ndërmarrjeve publike, në mënyrë që të ketë llogaridhënie për punën e tyre. Ajo kërkoi që të shihen mundësitë për angazhimin e ekspertëve në shqyrtim të projektligjeve dhe në çështje të tjera të fushëveprimit të komisionit.

Duda Balje, tha sa i përket monitorimit të ligjeve, si komision, duhet të përcaktohem për njërin ligj, sepse me këto diskutime nuk po mundemi të arrijmë në përfundim se për cilin ligj do të përcaktohem. Pra, mendoj se duhet të dalim me një përfundim nga kjo mbledhje.

Kryetarja, sqaroi se për çështjet që u ngritën e kemi paraparë edhe në planin e punës, që të ftohen ministrat e linjës dhe do të njoftohemi për së afrimi lidhur me zbatimin e Ligjit për Trepçën dhe si është situata në Trepçë. Po ashtu, do të informohemi edhe për kontratën për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re”, edhe për interkoneksionin me Shqipërinë. Ajo, po ashtu, sqaroi se gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, në të kaluarën, komisioni ka takuar dhe ka vizituar edhe palët e interesit. Lidhur me propozimin që të kemi ekspertë për mbështetje në punën e komisionit, ajo sqaroi se kemi pasur mbështetje në legjislaturën e kaluar nga organizata “INDEP” dhe organizata të tjera, edhe në këtë legjislaturë kanë shprehur gatishmëri, që ta mbështesin punën e komisionit me analiza për çështje të caktuara, dhe nëse dikush gjen ndonjë donator për mbështetje të komisionit, është i mirëseardhur. Po ashtu, komisionin e ka të ndarë një buxhet solid, të vetin, ku mund të angazhojë ekspertë për çështje të caktuara. Lidhur me shqyrtimin e raporteve të agjencive, tha se këtë vit është dashur që të shqyrtohen raportet për vitin 2016, por këto raporte kanë mbetur pa u shqyrtuar nga legjislatura e kaluar, pasi që Kuvendi u shpërnda, megjithatë tani mund të përcaktohem që të vizitohen agjencitë, për t'u informuar më shumë për punën e tyre. Ajo propozoi që së pari të vizitohet KPMM-ja, ku është ndërlidhur puna për Trepçën dhe KEK-un.

Dardan Sejdiu, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, propozoi Ligjin për energjinë elektrike, duke theksuar se propozimi është në linjë edhe me propozimin e z. Memli Krasniqi, që ligji të jetë nga fushëveprimi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Dardan Molliqaj, kërkoi që para se të vizitohen këto agjenci, të kenë raportet vjetore për vitin 2016, në mënyrë që të jenë më të informuar për punën e tyre. Propozoi që të kërkohet nga Qeveria, që ta sjellë edhe raportin për ndërmarrjet publike. Ndërsa, lidhur me vizitën në Shqipëri, kërkoi që t'i dërgohen marrëveshjet e Kosovës me Shqipërinë.

Pas diskutimeve, komisioni nxori këtë:

Përfundim

1. *Në plan të punës, të përfshihet:*
 - Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për energjinë elektrike;
 - Informimi nga ministri i Zhvillimit Ekonomik lidhur me kontratën me “Global Contour”, interkoneksionin me Shqipërinë dhe zbatimin e Ligjit për Trepçën.
2. *Të kërkohet prej Qeverisë që të sjellë Raportin e performancës së ndërmarrjeve publike.*
3. *Të kërkohet prej Qeverisë që Projektligji për masat mbrojtëse në importe, Projektligji për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese dhe Projektligji për tregtinë e brendshme, të procedohen në Kuvend bashkërisht si një pako e projektligjeve.*
4. *Kryetarja e komisionit dhe zëvendëskryetari Dardan Sejdiu, të takohen para se të miratohet plani dhe ta konkretizojnë planin e punës me propozimet që u ngritën.*

4. Të ndryshme

Kryetarja i njoftoi anëtarët e komisionit se janë proceduar raportet vjetore për vitin 2016, nga Autoritetit Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSST sh.a.), të cilat do të shqyrtohen në mbledhjet e komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetare e komisionit,

Sala Berisha – Shala
